



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 536, datë 30/12/2021

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM
TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME KONISPOL

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 42**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

Në mbledhjen e datës 30.12.2021 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetllës Kanalizime Konispol sh.a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

Konstatoi se:

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Konispol është licencuar me vendimin e KKRR nr. 39 datë 01.06.2018 "Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Konispol" për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Konispol ka aplikuar pranë ERRU për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, me shkresën nr. 123 prot, datë 14.12.2021 me lëndë "Lista e dokumentacionit të nevojshëm për unifikimin e tarifave të ujit për UK Konispol".

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Konispol është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendosjes së tarifave.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Konispol është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Konispol për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë.
2. Drejtoria Teknike Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Konispol dhe Bashkinë Konispol për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani